



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM
Nr. 144, dt. 16.07.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr. 75, dt.03.04.2015, “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” në mbledhjen e datës 16.07.2015, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për shoqërinë “Kestrina” sh.p.k, me drejtues teknikë z. Hekuran Halili me licencë personale restaurimi R.P.39 dhe z. Gligor Marto me licencë personale restaurimi R.P.38,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Kestrina” sh.p.k me drejtues ligjor z. Hekuran Halili për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për kategorinë CP. “Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “Kestrina” sh.p.k për kategorinë CP. “Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi” me drejtues teknik z. Hekuran Halili dhe z. Gligor Marto.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI



KRYETAR
MIRELA KUMBARO PURXHI

